



**Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo**



**Komuna e Prishtinës  
Opština Priština –Municipality of Prishtina**

**E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T**

**i mbledhjes së shtatë i Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 24.7.2024, duke filluar në orën 10:00.**

**Në mbledhje morën pjesë:** Fehmi Kupina - kryesues i komitetit, anëtarët e komitetit: Milazim Vitija, Jeta Rafuna, Dhurata Jahaj Retkoceri, Leutrim Retkoceri, Arbnora Berisha, Gëzim Sveçla, Nora Kelmendi, Mirsad Vitia dhe Bahri Gashi.

**Mungoi:** Shegë Beqiri.

**Në mbledhje ishin të pranishëm edhe:** Osman Bllaca - auditor, Valbona Makolli - drejtore e Drejtorisë së Financave, Lulzim Fushtica - drektor i Drejtorisë për Siguri dhe Emergjencë, Kushtrim Mushica - drektor i Drejtorisë së Sportit, Donat Lushaku – zëdhënës i Kabinetit të kryetarit, Fatos Dibra - udhëheqës i Zyrës ligjore dhe Florim Krasniqi- përfaqësues i Drejtorisë së Urbanizmit.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoit, Fehmi Kupina, kryesues i komitetit, me këtë:

**REND DITE**

1. **Miratimi i ekstraktit të procesverbalit i mbledhjes së pestë dhe të gjashtë të Komitetit për Politikë dhe Financa;**
2. **Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 prill - 30 qershor 2024 (TM2);**
3. **Propozim-vendimi për përkrahje financiare të klubeve sportive të Kryeqytetit dhe Eventit sportiv 3x3 Prishtina;**
4. **Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për kompaninë e menaxhimit të deponive në Kosovë (KMDK) SHA;**
5. **Propozim-vendimi për ndryshimin e riparcelizimit sipas gjendjes aktuale kadastrale (të banimi individual) të Planit rregullues "Prishtina e re - Zona perëndim", dhe ndërrimin e destinimit të BLL. I-1, Q-2, I-2, sipas destinimit të PZHU-së, në Prishtinë;**

- 6. Raporti i përgjithshëm i punës së Ndërmarrjes publike lokale “Stacioni i Autobusëve”, SHA, Prishtinë;**
- 7. Raporti i punës i Ndërmarrjes publike lokale për vitin 2023-2024 “Sport Marketing”, SHA;**
- 8. Informatë mbi punën e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi;**
- 9. Të ndryshme.**

Para se të fillonin me diskutimet për pikat e rendit të ditës, **Gëzim Sveçla** tha se ka një pyetje për zyrën ligjore që në mbledhjen e kaluar në Komitetin për Politikë dhe Financa, kanë kërkuar me bërë kërkesë për me iu drejtuar MAPL-së, lidhur me kompetencën e komitetit për me largu pika nga rendi i ditës, në këtë rast pyeti a iu është drejtuar zyra ligjore.

**Fatos Dibra:** nëse kryesuesi i drejtohet MAPL-së, është në rregull, por për zyrën ligjore është e qartë, nuk kam dilemë unë për këtë punë.

**Gëzim Sveçla:** tha ne jemi dakorduar që me iu drejtuar se nëse nuk drejtoheni ne kemi thënë se kthehem i në atë pjesën ku kemi vazhduar ne që i kemi hequr pikat nga rendi i ditës. Sa i përket pikës së pestë të rendit të ditës ka të bëjë me Propozim-vendimin e parcializimit, dokumentet shtesë të cilat i kemi kërkuar është vendimi që ka ardhur prej Gjykatës së Apelit dhe ai vendim nga Gjykata e Apelit nuk e obligon Kuvendin Komunal për asnjë veprim të vetëm, është shumë e qartë aty se obligohet Drejtoria e Urbanizimit, të veprojë sipas ligjeve në fuqi, në këtë rast Kuvendi nuk ka asnjë obligim, në raport me atë vendim të Gjykatës së Apelit, që është vendim i formës së prerë, andaj propozoi që pika e pestë e rendit të ditës të largohet nga rendi i ditës.

**Fatos Dibra:** tha sipas ligjit dhe udhëzimit administrativ për mua është e qartë ligjërisht se KPF-ja, nuk ka kompetencë me largua ose me shtua pika të rendit të ditës, dhe unë nuk kam marrë asnjë obligim, për të bërë ndonjë shkresë në MAPL, në mbledhjen e kuvendit mundet një anëtar me e propozuar, për të shtuar apo larguar propozimin e një pike në kuvend, rendi i ditës është kompetencë e kryesuesit dhe kryetarit të komunës, KPF-ja nuk vendos për rend të ditës.

**Gëzim Sveçla:** tha se ky Komitet për Politikë dhe Financa, në të kaluarën ka larguar dhe ka futur pika prandaj ne vazhdojmë ashtu nëse ti pretendon ndryshe dhe mendon se ka paligjshmëri, ke të drejtë me i nxjerr faktet, të cilat dëshmojnë të kundërtën, por jo interpretime personale.

**Fatos Dibra:** nuk janë personale.

**Kryesuesi:** tha Fatos a ka mundësi me na e dhënë me shkrim, që kemi drejtë apo nuk kemi drejtë, unë po e kërkoj se ju po thoni se është në kompetencë të kryesuesit dhe kryetarit, ma përcjell me email.

**Leutrim Ratkoceri:** tha sa i përket çështjes së Komitetit për Politikë dhe Financa, ligji është e vërtetë se kush e cakton rendin e ditës para takimit të KPF-së dhe para seancës, udhëzimi administrativ i cili fol për punën e komiteteve, nuk fol shprehimisht për Komitetin për Politikë dhe Financa dhe rolin e tij saktësisht, ka hapësirë ligjore të cilën, unë pajtohem që kryesuesi me kryetarin i përcaktojnë pikat e rendit të ditës deri në mbledhjen e KPF-së. Mbledhja e KPF-së, ka kompetencë për të propozuar, për dhe kundër këtij rendi të ditës, në Komitetin për Politikë dhe Financa përfaqësohet shumica, nuk i mohet e drejta as kërkuesit e as mohuesit të drejtës që në seancë mos të bëjë propozime, kështu që unë kam pritur që ta kem një interpretim ligjor, që e

kishte saktesar më shumë nga Ministria e Pushtetit Lokal. Po ashtu propozoi që të shtohen dy pika të reja të rendit të ditës:

-**Propozim – vendim për ndryshimin e emrit të rrugës “Ibrahim Lutfiu” me “Faruk Begolli”** këtu nuk ka ndryshime të mëdha që po kërkohet të vendoset emr i ri apo të largohet një tjetër, vetëm është zhvendosje gjatë arsyetimit, mundemi me pa edhe në google se ku janë këta emra, **dhe**

- **Propozim – vendimi që “Laura e Gërmisë” të kalojë në Ndërmarrje publike lokale “Gjelbër”,** ndërsa propozimi i dytë është propozimi të cilin e kemi pasur edhe në diskutim edhe më herët, është për shkak të një vendimi që ka ardhur nga nënkyetari i qeverisjes së kaluar, që laura e Parkut të Gërmisë, t'i kalojë një ndërmarrjeje publike, ai vendim është i jashtëligjshëm sepse kryetari i komunës nuk ka të drejtë të vendosë mbi pronën apo shfrytëzimin e pronës të asaj ndërmarrjeje, por është Kuvendi komunal në bazë të kësaj është një vendim dhe rregullore, qysh ka viti 1987, ku e përcakton Parkun e Gërmisë, park të mbrojtur dhe me ligjet e reja nuk ekziston më ajo rregullore se ka qenë e ish-sistemit, në vitin 2010. Parku i Gërmisë, është park i mbrojtur dhe hyn në mbrojtje me ligj dhe unë mendoj se është mirë t'i kthehet ish Ndërmarrjes Hortikultura apo Gjelbër. Po ashtu sugjeroi kryesuesin që me iu drejtuar administratës, se ka probleme në web-faqe, po hyj këtu në vitin 2014, në rregulloret për rendin e brendshëm në Parkun e Gërmisë, nuk ka qasje dhe në disa rregullore të tjera nuk është duke pasur qasje, është edhe një vërejtje tjetër në tetor të vittit të kaluar e kemi votuar, Rregulloren për dhënien në shfrytëzim më pak se 1 vit, ndërsa e publikuar nuk është. Ajo ka vazhduar, ka hyr në fuqi dhe nuk është e publikuar, si dhe nuk është e mirë për shkak të qasjes jozyrtare, transparencës dhe llogaridhënie para qytetarëve, vendimet dhe aktet që i nxjerr Kuvendi Komunal.

**Bahri Gashi:** besoj kryesues në këto raste kur kemi mospajtime me zyrën ligjore, zyra ligjore është nëpunës i komunës, kurse ne jemi të zgjedhur dhe ishte dashur që ju ose dikush me iu drejtuar Ministrisë për të bërë zgjidhje dhe të dalim nga kjo situatë.

**Kryesuesi:** tha se zyra ligjore e ka obligim.

**Fatos Dibra:** tha e kam dhënë sqarimin, e kam lexuar Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, unë nuk kam dyshime në këtë, për me e pyet ministrin për diçka që unë jam i sigurt, që është ashtu ligjore, shkresa mund të shkojë edhe nga kryesuesi.

**Kryesuesi:** meqenëse Fatosi tha kryesuesi duhet me iu drejtuar, në këtë rast Fatos, unë nga ju po kërkoj të ma dërgoni me shkrim këtë, nëse unë nuk pajtohem me juve, atëherë i drejtohem Ministrisë, unë tani për tani nuk mundem me ju anashkaluar juve me iu drejtuar Ministrisë.

**Bahri Gashi:** Leutrimi i pate dy propozime, njëra ishte për rrugën “Faruk Begolli”, ky komision është në pritje të një zyrtari të urbanizmit ku vazhdimisht të gjithë kemi kërkesa thirrje, të gjithë ne jemi duke e pritur atë zyrtar, a vendosim me dërguar në komision më mirë, për mos me fut në asamble, nëse pajtohesh edhe ti.

**Leutrim Retkoceri:** tha e vërtetë Bahri, se ishte dashur të shkojë ashtu, por komisioni nuk po funksionalizon për shkak të këtyre vonesave, kuvendi në rast se kishte me qenë emërtim i rrugës së re apo largimi i emrit të një rrugës ishte dashur të shkojë kah komisioni sepse nuk bënë me i tejkaluar kërkesat dhe këtu ka të bëjë me zëvendësim.

**Bahri Gashi:** Leutrim deri më 1 shtator nëse këta nuk bëjnë zgjidhje të urbanizmit, komisioni mund të bëjë

zgjidhje edhe me vazhduar pa atë. Të gjithë kemi në njëfarë presioni për rrugë, gjysmën e lagjeve të reja i ke pa adresa, kështu që mundemi me vazhduar edhe pa te, sepse ne nuk e kemi problem me emërtuar rrugë, kështu që 3 muaj jemi duke pritur për 1 njeri nuk mundet me mbetur peng komisioni se kjo është e drejtë e asamblesë jo e urbanizimit.

**Leutrim Retkoceri:** nuk ka asgjë që nuk bënë, me mirëkuptim ju kisha lutur, që të shkojë si propozim, është në vullnetin e juaj ndoshta kishte me qenë më mirë si reflektim për me lëvizë më shpejt.

**Bahri Gashi:** nëse hyn ky propozim mua më nxjerr problem shumë sepse i kam mbi 10000 kërkesa.

**Milazim Vitija:** dha sqarime sa i përket emërtimit të rrugëve, sa i përket ndërrimit të emrave, më herët kur kemi qenë në komisionin për emërtimin e emrave, të rrugëve dhe shesheve, ka qenë kërkesë së paku me qenë 51 % të banorëve që pajtohen me ndërrimin e atij emri në këtë rast nga "Ibrahim Lutfiu" në "Faruk Begolli", d.m.th. 51 %, të asaj lagjeje duhet me i dhënë nënshkrimet për ndryshim të këtij emri.

**Kryesuesi:** a mundem një pyetje në 2018 ke qenë në asamble a e keni marrë pëlqimin prej 51 anëtarëve, dy vendime që janë marrë që janë ndërruar sepse këtu ka vetëm ndërrim nuk ka emërtim.

**Milazim Vitija:** dha sqarime për pyetjen e parashtruar nga kryesuesi.

**Bahri Gashi:** Milazimi po thotë ashtu, por nuk është bash ashtu Milazim, nëse ka kërkesë prej banorëve për ndryshim apo emërtim të ri, ata vijnë me 15 % të emrave, nëse komisioni apo komiteti nuk e kërkojnë 15 %, mjafton një miratim i kuvendit dhe kuvendi merr vendim.

**Kryesuesi:** faleminderit z. Gashi, i kemi 3 propozime.

**Leutrim Retkoceri:** tha kryesues unë kisha thënë që le të shkojë me vullnet të komisionit propozimi. Ndërsa për têrheqjen e pikave të rendit të ditës dhe propozimet për t'i shtuar ato, të e bëjmë kështu, të presim interpretimin e MAPL-së, njëherë ka qenë qasja jonë që me i larguar, kemi lëshuar pe në seancën e kaluar për të pritur interpretimin, interpretimi nuk është, po rikthehemë në pozicionet tona. Le të vijë interpretimi tani nëse e përcakton ndryshe ne e bëjmë, nuk po bëjmë shkelje as civile e as penale për këtë punë, është procedurale kështu që në seancë mundet me u përsëritur prapë dhe me hy, unë kisha thënë me e hedh në propozim kush është për me i têrheq pikat, kush është kundër.

Kryesuesi e hodhi në votim propozimin e Gëzimit që të hiqet nga rendi i ditës pika e pestë: **Propozim-vendimi për ndryshimin e riparcelizimit sipas gjendjes aktuale kadastrale (te banimi individual) të Planit rregullues "Prishtina e re - Zona perëndim", dhe ndërrimin e destinimit të BLL. I-1, Q-2, I-2, sipas destinimit të PZHU-së, në Prishtinë.**

**Kryesuesi** konstatoi se me 6 pika për, 3 kundër, abstenim s'ka dhe Bahriu nuk voton, kjo pikë e rendit të ditës hiqet.

**Kryesuesi** e hodhi në votim propozimin e Leutrim Retkoceri **Propozim –vendimin për ndryshimin e emrit të rrugës " Ibrahim Lutfiu" me "Faruk Begolli".**

**Kryesuesi:** konstatoi se me 9 vota për, 1 votë kundër nga Bahri Gashi, kjo pikë hyn në rend dite.

**Kryesuesi** e hodhi në votim propozimin e Leutrim Retkocerit **Propozim –vendimi që “Laura e Gërmisë” tē kalojë në Ndërmarrje publike lokale - Gjelbër.**

**Kryesuesi:** konstatoi se 6 vota për, 3 vota kundër, 1 abstenim, kjo pikë hyn në rend dite.

**Osman Bllaca:** tha kam një informatë sa i përket biletave të Sany Hillit, 51 anëtarëve ju takon nga një biletë plus një tjetër.

**Kryesuesi:** tha mbas takimit unë shkoj e diskutoj këtë çështje me kryetarin.

**Leutrim Retkoceri:** tha çdo ftesë që vjen për evente, aktivitete, nëse nuk i vinë asamblistëve dy ftesa në zarfe në kuti postare mos i sillni hiç.

**Milazim Vitija:** tha kam një propozim qe sa herë e kemi propozuar lidhur me shujtën për punëtorë, duhet me gjete një formë ose shujtë ose pako ushqimore për zgjidhen e çështjes së punëtorëve të Komunës së Prishtinës mos t'i lëmë në këtë gjendje, mjete ka pse mos me iu realizuar. Ne jemi që mundemi me marrë një vendim dhe ju lutem tē gjithëve së bashku me gjete formën si me realizuar.

**Gëzim Sveçla:** tha këtë e kemi diskutuar edhe ne, unë ndihem me shqetësimin që e ka ngritur zotëri Vitija, ne LVV-ja e mbështesim çdo propozim, i cili ka mbështetje ligjore, mos sillni propozime që nuk kanë mbështetje ligjore që na kthehen, vetëm gjeni ju formën që ka bazë ligjore qoftë si ekzekutiv, si pushtet silleni eshtë në rregull edhe unë pajtohem se duhet me bërë zgjidhje vetëm gjeni formën ligjore.

**Kryesuesi:** tha se pajohet, por vetëm hajde e gjejmë mënyrën se si shujtë e di nuk kalon, kot e votojmë ne por nuk kalon, por si pako në tē kaluarën kështu e kemi kryer, është mirë këtu drejtoresha e financave më na dhënë sqarim lidhur me këtë çështje dhe me shikuar si me gjete mënyrën dhe e dërgojmë në seancë sepse gjithë jemi tē pajtimit me propozimin.

**Arbnore Berisha:** parashtroi pyetjen se nëse bëhet kjo zgjidhje a përfshihen edhe punëtorët, mirëmbajtësit e komunës.

**Kryesuesi:** tha tē gjithë punëtorët në kuadër tē Komunës që janë staf civil, përveç atyre që janë privat që nuk mundesh me i fut.

**Bahri Gashi:** tha se ka punuar më herët në Qeveri dhe ka qenë një ligj që në rast tē caktuar zyrtari më i lartë i institucionit e ka pasur tē drejtën m'i ndihmuar punëtorin e institucionit nëse ky ligj ekziston mënd tē përdoret për tē gjithë zyrtarët.

**Kryesuesi:** tha këtu po shihet vullneti i tē gjithëve vetëm tē gjejmë mënyrën e ligjshme.

**Valbona Makolli:** dha sqarime lidhur me çështjen e parashtuar nga parafolësit lidhur me çështjen e shujtave për punëtorët e Komunës.

**Leutrim Retkocer:** tha çështja që u ngrit unë mendoj është me rëndësi m'u kryer puna, por puna kryhet kur sigurohet baza ligjore, mundësia financiare buxhetore ku i marrin mjetet se ne mundem me votuar, por nuk

dihet ku po merren ato mjete dhe zyra ligjore nuk ka kompetenca vetëm nëse kryetari e autorizon zyrën ligjore, këtë duhet me sjell si propozim Kryetari dhe me dal me thënë ky është propozimi, këto janë mjetet mendoj dhe ejani ta votojmë, përgjegjësia është te zyrtari më i lartë te kryetari.

#### Pika e parë

**Miratimi i ekstraktit të procesverbalit i mbledhjes së pestë dhe të gjashtë të Komitetit për Politikë dhe Financa.**

**Kryesuesi konstatoi se u miratua ekstrakti i procesverbalit i mbledhjes së pestë dhe mbledhjes së gjashtë i Komitetit për Politikë e Financa.**

#### Pika e dytë

**Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 prill - 30 qershor 2024 (TM2)**

Lidhur me **Raportin financiar buxhetor të Komunës së Prishtinës për periudhën 1 prill - 30 qershor 2024 (TM2)** në pika të shkurta dha sqarime **Valbona Makolli**, duke cekur se i vemi ndryshim në këtë raport është se te detyrimet kontigjente e kishin sjell një cd me 17-18 faqe, ishin vetëm të dhënat e tyre që duhen me u proceduar për Kuvend sepse janë të gjitha paga jubilare nëse ju mendoni se duhet me qenë gjithë ai material unë i sjell, nëse jo vazhdojmë kështu.

**Arbnora Berisha:** pyetje te të hyrat që janë përfshirë edhe taksat për transaksion ndoshta gabim teknik është duhet me hiç këtu diçka.

**Kryesuesi:** tha se u përkrah **Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 prill - 30 qershor 2024 (TM2)** dhe dërgohet në Kuvend për diskutim.

#### Pika e tretë

**Propozim-vendimi për përkrahje financiare të klubeve sportive të Kryeqytetit dhe Eventit sportiv 3x3 Prishtina**

Lidhur me **Propozim-vendimin për përkrahje financiare të klubeve sportive të Kryeqytetit dhe Eventit sportiv 3x3 Prishtina** në pika të shkurta dha sqarime **Kushtrim Mushica**, ku ceku se tani ka ardhur si drejtor dhe e ka gjetur këtë pikë. Edhe herëve të kaluara e ka përkrah si pikë, po është praktikë e shumë viteve të kaluara dhe po ashtu edhe gjitha partitë e kanë përkrahur dhe është në të mirë të grupeve sportive, aktiviteve në kryeqytet, kështu që materialet sa e di të gjithë i keni.

**Gëzim Sveçla:** tha kam pasur pyetje për zyrën ligjore, por pasi zyra ligjore nuk është po i drejtohem auditorit çka mundet me na thënë auditori për këto të gjetura.

**Osman Bllaca:** dha sqarime lidhur me pyetjen e parashtruar nga parafolësi.

**Gëzim Sveçla:** tha këtu nuk është zyra ligjore për shkak se nuk e di a është obligim ligjor, por është procedurë e pashmangshme që çdo propozim që vjen nga ekzekutivi me kaluar nëpër filtra të zyrës ligjore që me ditur

se apo ju dërgon asamblesë me votuar diçka që është në mbështetje me ligjin. Këtu nuk është çështje private, por është çështje e buxhetit të qytetarëve të Prishtinës që po keqpërdoret për qëllime të caktuara, po zqidhen klube të caktuara në mënyrë jo të rregullt, po subvencionohen, janë të gjetura të auditorit. Këto nuk kanë me kaluar nga Ministria e Financave.

**Nora Kelmendi:** tha çka nënkupton me rast të veçantë, a mundeni me thirr Fatosin me na treguar se a ka shkuan përmes zyrës ligjore, nëse nuk ka shkuan subvencionimi përmes zyrës ligjore apo ndarja e mjeteve nuk bon as në KPF me ardhur nëse zyra ligjore s'e ka dhënë opinionin e vet.

**Kryesuesi** tha se u përkrah **Propozim-vendimi për përkrahje financiare të klubeve sportive të Kryeqytetit dhe Eventit sportiv 3x3 Prishtina** dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

#### Pika e katërt

**Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për Kompaninë e menaxhimit të deponive në Kosovë (KMDK) SH.A**

Lidhur me **Propozim-vendimin për ndarjen e mjeteve financiare për Kompaninë e menaxhimit të deponive në Kosovë (KMDK)**, në pika të shkurta dha sqarime **Donat Lushaku**, ku ceku se në cilësi të aksionarit kam ardhur. Ideja është m'i ndihmuar ndërmarrjes me mundësitet që i ka komuna sepse janë të limituara dhe 200 mijë euro janë për subvencionim të borxhit të përgjithshëm që me sa di janë zbrit nga 1 milion e 100 mijë në 900 mijë dhe kjo për mos me pamundësuar në njëfarë forme mbylljen e deponisë, sigurisht nuk është e mjaftueshme kryeshefi KMDK në takimet që i kemi pasur ka thënë që aksionar e ka Ministrinë e Tregtisë që kanë kërkuar gjithsesi m'i mbyll dyert, por e ka pasur një mirëkuptim dhe Mirashi e ka shtyrë afatin.

**Gëzim Sveçla:** pyeti se cili ka qenë opinoni i zyrës ligjore dhe a kemi të drejtë për arsyen se po flasim për buxhet komunal që po i jepet një Ndërmarrjeje të nivelit qendror.

**Donat Lushaku:** dha sqarime për pyetjen e parashtruar nga Gëzimi.

**Gëzim Sveçla:** pyeti se Kompania “Pastrimi” a është diku te përbartuesi se ne nuk guxojmë me ia liruar mjetet atyre.

**Donat Lushaku:** tha këtë duhet me verifikuar se ka disa procese që janë në përbartim, mundemi me verifikuar me marrë më saktë dhe ideja ka qenë që me kryer si procedurë më shpejt dhe fundja mundemi me ndryshuar.

**Gëzim Sveçla:** tha se hallin e ka se nëse paraqet problem aspekti ligjor, se buxheti komunal m'u nda për Ndërmarrjen e Nivelit Qendror e mandej ky transaksion ndërpritet dhe vonohet. Është mirë deri në seancë me pyet edhe në Ministri të Financave për shkak se ky si vendim ka impakt financiar dhe kalon nëpër filtra të Ministrisë së Financave nëse është e realizueshme në rregull është, nuk e kam problem a shkruan KMDK apo “Pastrimi”.

**Donat Lushaku:** tha se është pranuar si KMDK, janë dy elemente kjo çështja e përbartimit me ditë saktë a ka procese e që unë mundem me thënë që ka dhe e dyta është kjo pjesa pranuese e transferit.

**Jeta Rafuna:** për çështjet që i tha Donati pajtohem plotësisht për formën ligjore dhe përmbaruesin.

**Leutrim Retkoceri:** tha sa i përket këtij vendimi për subvencionim Kompania "Pastrimi" nga fillimi kur janë ndërruar aksionarët kompania është gjetur me 2 milionë euro borxhe, shumica e borxheve ka qenë ndaj deponisë. Problemi qëndron se borxhet ndaj deponisë janë sepse janë borxhe të vjetra dhe as deponia nuk mundet m'i përmbaruar për shkak se janë borxhe të mëdha. Por funksionalizimi i ndërmarrjes, mbyllja e derës, mospranimi i shërbimit është e drejtë e Kompanisë me bë ndaj "Pastrimi" pa u shlyer këto borxhe në tërsi, vitin e kaluar ka qenë një subvencionim 200 mijë euro që e ka zbrit këtë borxhin e vjetër. Raporti i auditimit Ndërmarrjen "Pastrimi" e ka nxjerr në njérën prej tri ndërmarrjeve më të mira në opinion të pakualifikuar të auditimit dhe kjo nuk kishte mundur me ardhur nëse kishte me pas përmbarues dhe probleme të tjera financiare që është e vërtetë që ka pas, por janë rregulluar. Është një çështje tjetër që duhet me trajtuar se ky borxh 900 mijë euro është i vjetër që duhet m'u marr. Në tetor të vitit të kaluar ne në Kuvend e kemi nxjerr një vendim i cili ka pas me iu bartur Kompanisë "Pastrimi" 850 mijë euro, 350 mijë euro për blerjen e pajisjeve dhe 500 mijë euro për mbylljen e gjysmës së borxhit ndaj deponisë. Shuma prej 200 mijë eurove për me mbyll këtë borxh 900 mijë është i vogël, unë mendoj që shuma prej 200 mijë euro nuk po bënë zgjidhje m'u rrit, në të kaluarën ne kemi bë vendim për 14 % të alokimit të buxhetit me iu ndarë me 500 mijë euro. Janë edhe disa kriteri që KFV-ja Gjermane i kërkon për ta ndarë grantin prej 40 milionë eurove për kompani dhe nuk mund t'i ndajë derisa komuna dhe kompania si aksionar më madh m'i adresuar problemet dhe borxhet e tyre që i kanë mbetur. Çështje tjetër është edhe pajisja me kamion të rinj ku e di deri ku është kjo procedurë, se me çfarë mjete punon ajo ndërmarrje është shqetësuese për rreziqet që paraqiten janë të mëdha për punëtorë dhe qytetarë.

**Donat Lushaku:** dha sqarime për çështjet që i paraqiti parafolësi.

**Gëzim Sveçla:** tha a është inkasimi për mbeturina apo për deponi.

**Leutrim Retkoceri:** dha sqarime se inkasimi duhet t'i bëhet kompanisë që dërgon mbeturina në KMDK.

**Bahri Gashi:** tha ky është borxh mbi 15 vite, për këtë është borxh i vjetër dhe ajo kompani gjithmonë ka pasur telashe e kemi diskutuar sa herë në seanca që m'u gjend një zgjidhje përfundimtare dhe m'u mbyll këto obligime. Këtu qenka caktuar shuma prej 200 mijë euro është mirë m'u zgjeruar dhe m'u bë një zgjidhje se në këtë mënyrë nuk bëhet zgjidhje.

**Kryesuesi** tha se u përkrah **Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për Kompaninë e menaxhimit të deponive në Kosovë (KMDK) SHA** dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

**Pika e pestë**

**Propozim-vendimi për ndryshimin e riparcelizimit sipas gjendjes aktuale kadastrale (te banimi individual) të Planit rregullues "Prishtina e re - Zona perëndim", dhe ndërrimin e destinimit të BLL-I-1, Q-2, I-2, sipas destinimit të PZHU-së, në Prishtinë.**

**Kryesuesi:** tha se pika e pestë me propozimin e Gëzimit u tërhoqi nga rendi i ditës.

**Pika e gjashtë**

**Raporti i përgjithshëm i punës i Ndërmarrjes publike lokale "Stacioni i Autobusëve", SH.A, Prishtinë**

**Kryesuesi tha se u përkrah Raporti i përgjithshëm i punës i Ndërmarrjes publike lokale “Stacioni i Autobusëve”, SH.A, Prishtinë dhe dërgohet në Kuvend për diskutim.**

**Pika e shtatë**

**Raporti i punës i Ndërmarrjes publike lokale për vitin 2023-2024 “Sport Marketing”, SH.A;**

**Kryesuesi tha se u përkrah Raporti i punës i Ndërmarrjes publike lokale për vitin 2023-2024 “Sport Marketing”, SHA dhe dërgohet në Kuvend për diskutim.**

**Pika e tetë**

**Informatë mbi punën e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi**

Lidhur me **Informatën mbi punën e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi** në pika të shkurta dha sqarime **Lulzim Fushtica**. Ai tha kjo është kërkesë prej Kuvendit që ka ardhur që Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi e ka obligim që brenda vitiit dy herë të raportojë për punën, unë këtë raport e kom dorëzuar kjo ka ndodhur para dy takimeve dhe kanë ndodhur edhe disa gjëra gjatë këtyre takimeve kështu që do t'i raportojë në seancë.

**Bahri Gashi:** tha se je zotuar se do të na thërrasësh në takim të Këshillit por nuk e bëre asnjëherë.

**Lulzim Fushtica:** tha se kryetari është kryesues unë jam si i deleguar i kryetarit ose si zyrtar që e bënë menaxhimin e zgjedhjeve në bazë të ligjit d.m.th udhëzimit administrativ. Ju mund të vini në mbledhje të Këshillit komunal, jeni të deleguar me qenë anëtarë, ju njoftojmë për takimin e radhës.

**Të ndryshme**

**Valbona Makolli:** tha siç jemi njoftuar javën e ardhshme janë dëgjimet publike për buxhet, e kemi nderin me na u bashkangjitur edhe asamblistët.

**Gëzim Sveçla:** pyeti a ka draft të buxhetit.

**Valbona Makolli:** tha se njëherë janë dëgjimet, e presim qarkoren e pastaj bëhet draft-buxheti.

**Gëzim Sveçla:** tha unë pyeta për raportin e auditimit, kurse për planin e veprimit e mora përgjigjen.

*Mbledhja përfundoi në orën 11:45 .*

**Procesmbajtësja  
Shyhrete Islami**

**Kryesues i Komitetit  
Fehmi Kupina**

